



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Nr. 2/10 Prot.

Tiranë, më 21.08.2025

VENDIM

Nr. 3, datë 21.08.2025

**“PËR PËRCAKTIMIN E PËRQINDJES SË NDARJES SË SHPËRBLIMEVE
TË MBLEDHURA PËR AGJENCITË E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV:
F.A.A.D DHE ALBAUTOR”**

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga Agjencia e Administrimit Kolektiv (“AAK”) në fushën e të drejtave të autorëve dhe producentëve të veprave audiovizuale (“F.A.A.D”) më lëndë “Për përcaktimin e përqindjeve të ndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK-ve F.A.A.D dhe ALBAUTOR”, Këshilli Kombëtar Për Të Drejtën e Autorit (“KKDA”) përfundoi procedurën administrative lidhur me këtë kërkesë dhe mori vendimin përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pala kërkuuese: AAK “F.A.A.D”, përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv Z. Evien Dako

Objekti: Përcaktimi i përqindjeve të ndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK-ve “F.A.A.D” dhe “ALBAUTOR”

Palët e interesuara: AAK “Albautor”, përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv Z. Erion Muka
SUADA, përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv Z. Elton Kallfa

Baza ligjore: Nenet 131, 138 (8) dhe (9), 142 e në vijim, dhe 156 të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” (i ndryshuar);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

Kreu II, pikat (4), (5) dhe (7) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 35, datë 18.01.2017 “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA), i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 27.11.2024;

Vendimi i KKDA-së Nr. 2, datë 20.04.2017 “Për miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Autorit (KKDA)”

I. Pjesa hyrëse

1. Agjencitë e administrimit kolektiv (“AAK”) janë subjekte juridike të krijuara nga mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbledhjen e të ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërndarjen e tyre tek titullarët e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, të cilat kanë marrë licensimin nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit pas propozimit nga Drejtoria e të Drejtave të Autorit (“DDA”).

2. “F.A.A.D” është agjencia e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të autorëve dhe producentëve të veprave audiovizuale, e cila ka marrë licensimin nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit pas propozimit nga DDA.

3. “Albautor” është agjencia e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të autorit për veprat letrare, artistike dhe shkencore, përveç administrimit kolektiv të të drejtave të autorit në fushën e veprave audiovizuale, në të cilat përfshihen edhe veprat kinematografike, e cila ka marrë licensimin nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit pas propozimit nga DDA.

4. Sporteli unik për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve (“SUADA”) është një subjekt juridik që regjistrohet si organizatë jofitimprurëse, i cili është krijuar me ligj¹ për të kryer shërbimet për funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave në administrimin kolektiv, të mbrojtura nga të gjitha agjencitë e administrimit kolektiv të licensuara.

5. Në bazë të nenit 138 (8) të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” (i ndryshuar) (“LDA”), ndarja e shpërblimeve të mbledhura ndaj AAK-ve kryhet si më poshtë:

- a) 40% do t’u shkojë përfaqësuesve të të drejtave të autorit;
- b) 30% do t’u shkojë përfaqësuesve të të drejtave të interpretuesve;
- c) 30% do t’u shkojë përfaqësuesve të të drejtave të prodhuesve (producentëve) të filmave, të botuesve dhe prodhuesve të fonogramit.

Për sa më sipër, sipas nenit 138 (9) të LDA-së, përqindja (%) e ndarjes së shpërblimeve të mbledhura nga SUADA për AAK-të përcaktohet me vendim të KKDA-së.

¹ Neni 138 i ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” (i ndryshuar)

6. KKDA-ja funksionin si organ kolegjal vendimarrës pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit, dhe përbëhet nga kryetari dhe 4 (katër) anëtarë, të cilët emërohen nga ministri përgjegjës për të drejtën e autorit për një periudhë katërvjeçare.

KKDA-ja ushtron veprimtarinë dhe kompetencat e saj bazuar në LDA-në dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Në bazë të legjislacionit në fuqi, KKDA-ja ka kompetencë dhe diskrecion të vendosë për:

- a) miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit për përdorimin e të drejtave të autorit, kur këto tarifa nuk janë të mundura të vendosen me anë të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ndërmjet AAK-ve dhe përfaqësuesve të shoqatës së përdoruesve;
- b) çdo pretendim të palëve për përfundimin e marrëveshjes, duke përfshirë përqindjen e ndarjes së shpërblimeve të mbledhura për agjencitë e administrimit kolektiv.

7. Në vijim për sa më sipër, F.A.A.D i është drejtuar KKDA-së dhe DDA-së² me kërkesën nr. 6961/3 Prot., datë 18.06.2022 me objekt: “Për përcaktimin e përqindjeve të ndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK-ve F.A.A.D dhe ALBAUTOR”.

KKDA mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga F.A.A.D, e cila u vlerësua si e rregullt në aspektin formal:

- Kërkesa e F.A.A.D-së është në përputhje me nenin 144 (3) të LDA-së dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative (“KPA”);
- KKDA-ja ka kompetencë të shqyrtojë kërkesën dhe të marrë vendimin për përcaktimin e përqindjes së ndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK-ve, në kuptim të nenit 138 (9) të LDA-së;
- F.A.A.D legjitimohet të paraqesë kërkesën në cilësinë e palës së interesuar;
- LDA nuk parashikon ndonjë afat kohor brenda të cilit duhet depozituar kërkesa, por kërkesa e F.A.A.D-së konsiderohet e depozituar në afat për sa kohë nuk është miratuar një vendim për përqindjen e ndarjes së shpërblimeve të mbledhura nga SUADA për AAK-të;
- Kërkesa përmban të dhënat identifikuese për aplikantin, shpjegimet mbi çështjen dhe evidenton faktin se negociatat për marrëveshje nuk kanë përfunduar me sukses.

² DDA-ja funksionon si sekretariat teknik i KKDA-së, në zbatim të dispozitave të LDA-së, sipas nenit 157 (3) të LDA-së

Në vijim për sa më sipër, KKDA-ja miratoi fillimin e procedurës administrative në lidhje me këtë kërkesë dhe kërkoi nga F.A.A.D që të paraqesë disa materiale shtesë në lidhje me argumentimin ligjor të kërkesës së tyre, sipas nenit 144 (6) të LDA-së dhe nenit 8 (7) të VKM-së nr. 2, datë 20.04.2017 “Për miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Autorit (KKDA)”.

8. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, KKDA-ja njoftoi palën tjetër e interesuar – AAK “Albautor” - dhe e ftoi atë të paraqesë qendrimin dhe opinionet e tyre në lidhje me kërkesën.

9. Albautor mori pjesë në këtë procedurë administrative në mënyrë aktive dhe depozitoi qendrimet dhe opinionet e tyre me shkrim në lidhje me sa më sipër:

- Shkresa nr. 8158 Prot., datë 19.06.2025 me lëndë “Shpjegime në lidhje me përcaktimin e përqindjeve, mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK “F.A.A.D” dhe AAK “Albautor”;
- Shkresa nr. 8710 Prot., datë 30.06.2025 me lëndë “Shpjegime plotësuese në lidhje me përcaktimin e përqindjeve, mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK “F.A.A.D” dhe AAK “Albautor”.

10. Më datë 01.07.2025, F.A.A.D paraqet dokumentin me objekt: “Plotesim argumentash, Kërkesës tonë “Për përcaktimin e përqindjeve të ndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK-ve F.A.A.D dhe ALBAUTOR”.

11. Në vijim për sa më sipër, duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes dhe volumin e materialeve të paraqitura nga palët, si dhe me qëllim për të kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm administrativ përpara vendimarrjes, KKDA-ja procedoi si më poshtë vijon:

- Më datë 26.06.2025, KKDA-ja zhvilloi një mbledhje të përbashkët me përfaqësuesit e F.A.A.D dhe Albautor. Në përputhje me LDA-në, KKDA-ja iu drejtua edhe një herë paraprakisht palëve nëse ekzistonte mundësia për të zgjidhur këtë çështje me marrëveshje, por qendrimi i tyre ishte diametralisht i kundërt dhe nuk u verifikua asnjë mundësi që palët të arrinin një marrëveshje. Në vijim të mbledhjes, secila prej palëve u ftua si rrjedhojë të parashtrojë në mënyrë të përmbledhur verbalisht dhe/ose me shkrim të gjithë shpjegimet, propozimet dhe qendrimet e tyre.
- Në po të njëjtën datë, KKDA-ja zhvilloi një tjetër mbledhje më vete vetëm me përfaqësuesit e SUADA-s për të kuptuar më mirë këndvështrimin e tyre në lidhje me këtë çështje dhe për të siguruar informacionin e duhur në lidhje me mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK-ve.
- Në vijim të procedurës administrative, KKDA-ja i caktoi palëve afatin ligjor për të paraqitur shpjegimet/konkluzionet e tyre përfundimtare mbi këtë çështje.

12. Në përfundim të procedurës administrative pranë KKDA-së, palët paraqitën shpjegimet/konkluzionet e tyre përfundimtare dhe propozimet përkatëse për mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave ndërmjet tyre.

13. Më datë 07.07.2025, KKDA-ja zhvilloi një tjetër mbledhje në ambientet e MEKI-t, dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe informacionin e paraqitur në kuadër të procedurës administrative për miratimin e përqindjeve, mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK-ve “F.A.A.D” dhe “Albautor”, vlerësoi se çështja paraqet një shkallë shumë të lartë kompleksiteti që kërkon një analizë dhe konsultime më të thelluara në drejtim të vendimmarrjes.

Në këtë kuadër, për të garantuar një vendimmarrje sa më të drejtë, transparente dhe në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe mbrojtjes së interesit të mbajtësve së të drejtave dhe subjekteve përdoruese, u çmua e nevojshme zgjatja e afatit të shqyrtimit dhe vendimmarrjes për një periudhë shtesë prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, në përputhje me nenin 92 të KPA-së.

II. Argumentet dhe propozimet e palëve

14. Gjatë procedurës administrative, palët paraqitën argumentet, shpjegimet dhe propozimet e tyre si me shkrim, ashtu edhe verbalisht në seancën dëgjimore të caktuar nga KKDA-ja.

Në lidhje me dokumentacionin shkresor të paraqitur nga palët dhe të administruar nga KKDA-ja në kuadër të shqyrtimit të çështjes, më poshtë renditen të gjithë materialet e paraqitura nga palët:

▪ Pala kërkuese – F.A.A.D ka paraqitur dokumentacionin dhe materialet shkresore e mëposhtme:

1. Shkresa nr. 6961/3 Prot., datë 18.06.2025, me titull “Parshtime” dhe me objekt “Kërkesës tonë “Për përcaktimin e përqindjeve të ndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK-ve F.A.A.D dhe ALBAUTOR”;
2. Materiali datë 01.07.2025, me titull “Parashtime” dhe objekt “Plotësim argumentash, Kërkesës tonë “Për përcaktimin e përqindjeve të ndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK-ve F.A.A.D dhe ALBAUTOR”;
3. Shkresa nr. 6961/4 Prot., datë 07.07.2025, me titull “Konkluzione përfundimtare” dhe me objekt “Konkluzione përfundimtare. Kërkesës tonë “Për përcaktimin e përqindjeve të ndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK-ve F.A.A.D dhe ALBAUTOR”.

▪ Pala tjetër e interesuar dhe pjesëmarrësë në këtë procedurë, Albautor, ka paraqitur dokumentacionin dhe materialet shkresore e mëposhtme:

1. Shkresa nr. 8158 Prot., datë 19.06.2025, me titull “Shpjegime” dhe me objekt “Përcaktimi i përqindjeve, mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK “FAAD” dhe AAK “Albautor”;

2. Shkresa datë 26.06.2025, me titull “Shpjegime shtesë” dhe me objekt “Shpjegime shtesë në lidhje me përcaktimin e përqindjeve të ndarjes së shpërblimeve të mbledhura ndërmjet AAK “FAAD” dhe AAK “Albautor”, dhe anekset përkatëse bashkëlidhur siç vijon:
 - Aneksi 1: Letra të studiove kinematografike drejtuar agjencisë “Musicautor”;
 - Aneksi 2: Kontrata transmetimi mes QKK - RTSH në vitin 2018 dhe 2022;
 - Aneksi 3: Statistika CISAC;
 - Aneksi 4: Dokument sqarues i agjencisë franceze që mbulon audiovizualin, SACD;
 - Aneksi 5: Shkresa AMA;
 - Aneksi 6: Studim për të drejtat muzikore në veprat audiovizuale.
3. Shkresa nr. 8710 Prot., datë 30.06.2025, me titull “Shënime plotësuese” dhe me objekt “Shënime plotësuese në lidhje me përcaktimin e përqindjeve të ndarjes së shpërblimeve të mbledhura ndërmjet AAK “FAAD” dhe AAK “Albautor”;
4. Materiali datë 07.07.2025, me titull “Shpjegime përfundimtare” dhe me objekt “Përcaktimi i përqindjeve, mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK “FAAD” dhe AAK “Albautor”;
5. Materiali me titull “Tabelë me propozimet e agjencisë Albautor për përqindjen e ndarjes së shpërblimeve të mbledhura mes agjencive Albautor dhe FAAD (pjesa e autorëve 40% = 100%).

15. Në mënyrë të përmblodhur, pala kërkuese – AAK-ja “F.A.A.D” - parashtrohet se:

- *F.A.A.D., sipas Statutit, përfaqëson: Regji, skenar, drejtor fotografie dhe producent. Të gjithë këto persona konsiderohen detyrimisht si bashkëautorë nga F.A.A.D;*
- *Edhe pse prodhuesi audiovizual nuk është autor në kuptimin klasik, ai ka një rol kyç në financimin, organizimin dhe përgatitjen e veprës, dhe ka të drejtën për shfrytëzimin ekonomik të veprës nëpërmjet kontratës me autorët;*
- *Tarifa për përdorimin e veprave audiovizuale duhet të jetë të paktën dy herë më e lartë se ajo që aplikohet aktualisht për autorët e muzikës dhe prodhuesit e fonogramëve. Kjo përbën një masë të justifikuar, në përputhje me standartet europiane dhe nevojën për një shpërblim të drejtë e proporcional;*
- *Duke marrë marasysh muzikën e krijuar për filmin dhe jo atë ekzistuese, audiovizuali ka kosto minimale më të mëdha, gjatësi veprë shumëfish më të madhe, më shumë*

krijues/bashkëautorë dhe fitime më të mëdha për shkak të përfshirjes së reklamave në raport me muzikën;

- *Cilat janë format e përdorimit dhe kujt i takon shpërblimi, duke listuar sipas rendit: Transmetimi në radio, transmetimi televiz, ritransmetimi, kopja private, përdorimi në ambientet publike – HORECA (hotele, restorante, kafene), shfaqje në kinema, transmetimi online dhe performanca live (koncerte);*
- *Muzika do të ndahet 30% AKDIE, 15% FABER (në kushtet e mungesës së licensës për videogram) dhe 40% ALBAUTOR (15% e FABER, në rastin më të mirë i kalon F.A.A.D si audiovizual sepse përmban prodhues videogrami, regji dhe operator, ose në rastin më të keq i mbetet SUADA e pashpërndarë deri në një vendim të rilicensimit të FABER edhe për videogramin);*
- *Pjesa takuese e Audiovizualit do të ndahet 40% autorët, 30% prodhuesit e filmit, 30 % interpretuesit.*
- *Në praktikën e mira botërore, si dhe referuar kategorizimit të muzikës në audiovizual, maksimumi i muzikës fillon nga 5%-10% për muzikën e krijuar për veprën audiovizuale, dhe 20%-25% për veprën ekzistuese.*
- *Në lidhje me llogaritjen e muzikës nga pikëpamja sasiore në një vepër audiovizuale, mjafton të llogarisësh, gjatësinë e veprës audiovizuale dhe atë të muzikës, dhe lehtësisht del përqindja se sa vend zë muzika në audiovizual.*
- *Të ardhurat e agjencive të audiovizualit sipas S.A.A. përbëhen nga 37% që vijnë nga transmetuesit dhe 25% që vijnë nga ritransmetuesit. E kthyer kjo në llogaritjen e të ardhurave që mbledh SUADA për autorët, minimalisht 62% duhet t'i kalojnë audiovizualit nga kjo kategori dhe pjesa tjetër nga sistemi HORECA.*
- *Ndarja e të ardhurave: F.A.A.D – 65%, ALBAUTOR – 5%, Interpretuesit – 30%. Kjo ndarje mbështetet në bazën ligjore, rekomandimet e CISAC dhe SAA, dhe argumentet praktike:*

F.A.A.D është pjesë më komplekse dhe krijuese në krijimin audiovizual, prandaj merr 65%;

ALBAUTOR përfaqëson autorët e muzikës, që në audiovizual është një pjesë e kufizuar, prandaj 5% është e përshtatshme;

Interpretuesit i japin jetë veprës dhe meritojnë 30%.

- *Në lidhje me transmetimin, bazuar në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe në praktikën e CISAC dhe S.A.A, transmetuesit televizivë kanë detyrimin ligjor dhe moral për të paguar Agjencinë e Administrimit Kolektiv të Audiovizualit (AAK) për përdorimin e veprave audiovizuale.*

Në konkluzionet përfundimtare, F.A.A.D parashtrohet këto përfundime:

- *Baza ligjore ku mbështeten pretendimet janë nenet 97 dhe 100 (2) të LDA-së, ku neni 97 përcakton se kush janë autorët duke i dhënë edhe indirekt vlerën që ka një vepër*

audiovizuale ,dhe neni 100 (2) saktëson se marrëdhënia e të drejtës ndërmjet producentit/prodhuesit të veprës me autorët përcaktohet vetëm sipas kontratës mes tyre;

- Albautor prezumon ekzistencën e një kontratë ndërmjet transmetuesit dhe prodhuesit që i ka kaluar të gjithë të drejtat TV, ndërsa në rastin e muzikës, prezumon se nuk ekziston asnjë prodhues/publisher që i ka kaluar të gjithë të drejtat e autorit transmetuesit;
- F.A.A.D i takon 65% e të ardhurave nga audiovizuali dhe pasi arkëton shumën, është F.A.A.D që verifikon kontratat e depozituara nga prodhuesit apo AAK-të simotra, dhe verifikon nëse i takojnë prodhuesit apo jo.
- F.A.A.D gëzon plotësisht të drejta të përfitojë të ardhura nga aktiviteti i transmetimit.
- Propozimi konkret dhe përfundimtar i F.A.A.D për përcaktimin e përqindjeve dhe ndarjen e shpërblimit të të ardhurave është si vijon:

KATEGORIA	F.A.A.D	ALBAUTOR
Transmetues audiovizuali, muzikë e filmit	65 %	5 %
Transmetues audiovizuali, muzikë eksiztuese	45 %	25 %
Ritransmetimi i audiovizualit	65 %	5 %
Muzika në Transmetues audiovizual	-	40 %
Radio	-	40 %
Dhoma e hotelit	65 %	5 %
Ambiente të tjera komunikimi në publik	20 %	20 %

16. Në mënyrë të përmbledhur, pala tjetër e interesuar dhe pjesëmarrëse në këtë procedurë administrative – AAK-ja “Albautor”- parashtrohet se:

- Shpjegimet dhe kërkesat tona janë në zbatim të nenit 138 (8) dhe (9), dhe nenit 156 (4)(b) të LDA-së.
- Një vështrim i shkurtër historik mbi mënyrën e ndarjes së të ardhurave ndërmjet AAK-ve.
- Thelbi i çështjes lidhet me mbledhjen e të ardhurave përmes sistemit kolektiv dhe jo individualisht.
- Rastet e administrimit të detyrueshëm parashikohen në nenin 131 të LDA-së, dhe me rëndësi për çështjen e ndarjes së të ardhurave janë dy dispozita të LDA-së: neni 130 (1) (a) dhe neni 130 (1)(f).

- Nëse i referohemi dispozitës së parë, nenit 130 (1)(a) të LDA-së, kjo dispozitë i referohet:
 - i. Të drejtës së transmetimit, ritransmetimit dhe përcjelljes në publik, të cilat janë veprimet kryesore që përbëjnë komunikimin në publik të një vepre.
 - ii. Llojit të veprave “vepra joskenike, muzikore dhe letrare”.
- Për sa i përket “veprave muzikore”, është e qartë se ato do të përfshijnë të gjithë veprat muzikore e komunikuar në publik, qofshin ato të përdorura në një film, emision, spektakël, dokumentar, pra në çdo element programacioni të OSHMA-ve dhe/ose operatori kabllor. Ndërkohë, fakti që ligjvënësi i ka trajtuar në mënyrë të veçantë veprat audiovizuale, të ndara nga veprat e tjera brenda vetë nenit 130 të LDA-së, kuptohet se qëllimi i ligjvënësit është të ketë një trajtim të veçantë për veprat audiovizuale për shkak të specifikës që ato kanë, specifike që nxit administrimin individual dhe jo atë kolektiv.
- Termi “vepër skenike” nuk është përkufizuar shprehimisht në ligj, por referuar kuptimit të fjalës “skenë” dhe mbiemrit “skenike” sipas fjalorit shqiptar, “veprat skenike” duhet të kenë elementin skenik si element primar të identifikimit të tyre. Në këtë kuptim, administrimi kolektiv i detyrueshëm për komunikimin e veprave në publik nëpërmjet transmetimit, ritransmetimit dhe përcjelljes në publik mbulon vetëm veprat muzikore, letrare dhe joskenike, të kuptuara si çdo krijim tjetër që nuk ka për bazë krijimin skenik. Nëse i referohemi dispozitës së dytë, nenit 130(1)(f), administrimi kolektiv i detyrueshëm përfshin “të drejtën e ritransmetimit të veprave audiovizuale”.
- Nga analiza e dy dispozitave, arrihet në përfundimin se qëllimi i ligjvënësit është që të përcaktonte se cilat veprime dhe cilat vepra do të kenë administrim të detyrueshëm. Mospërfshirja e veprave audiovizuale në kategorinë e dispozitës së parë - nenit 130 (1)(a) - tregon se për këto vepra do të privilegjohej parimi i administrimit individual të të drejtave, me përjashtim të rasteve të ritransmetimit të tyre.
- Përkufizimi i ritransmetimit, kriteri ligjor në lidhje me konceptin e ritransmetimit, dhe fakti se AMA lëshon licensën ku specifikohet qartësisht se cilat janë subjekte të autorizuar për ritransmetimin dhe cilat jo.
- Në përfundim nga sa më sipër, administrim kolektiv kemi për transmetimet dhe ritransmetimet e veprave muzikore, joskenike dhe letrare, dhe vetëm për ritransmetimet për veprat audiovizuale. “Veprat audiovizuale” nuk mund të mos kuptohen si vepra skenike, për shkak të faktit se ato kanë në përbërjen e tyre elementin skenik si element primar.
- Përfshirja vetëm e veprave audiovizuale në administrimin e detyrueshëm kolektiv vetëm për ritransmetimet është një përkthim i marrëdhëniës kontraktore që një producent vendos me distributorët e filmave dhe ky i fundit me OSHMA-të. Konkretisht, në kuadër të transmetimit të veprave, të gjithë pagesat për krijuesit e tjerë (regji, skenar dhe kompozim – për kompozimet origjinale të filmave) janë shlyer tashmë me pagesën që OSHMA-ja ka kryer tek subjekti që shpërndan filmin dhe që zotëron të

drejtat. Pra, shpërndarja e pagesave që merr Sporteli Unik nga OSHMA-të për “filmat, serialet dhe telenovelat” duhet të kryhet në mënyrë ekskluzive vetëm te Albautor (kuptohet për atë pjesë që i takon autorëve).

Çdo shpërndarje tjetër për këto lloj veprash do të ishte në kundërshtim me ligjin dhe praktikat ndërkombëtare dhe do të çonte në një situatë jokohërente ku për të njëjtën kategori autorësh do të bëheshin dy pagesa – një në mënyrë direkte nga OSHMA tek shpërndarësit e veprave audiovizuale dhe një tjetër tek agjencia kompetente për audiovizualin.

Në rastin e muzikës, një prodhues nuk është njësoj me një publisher sepse prodhuesi nuk është prodhues i veprës, por i fonogramit. Së dyti, publisher ose editori nuk parashikohen në ligjin tonë. Për këtë arsye, analogjia e F.A.A.D nuk qëndron.

- Raste përjashtimore për veprat filmike ose kinematografike shqiptare të krijuara përpara 1990, të cilat nuk duhet të llogariten në shpërndarjen e përgjithshme ndërmjet AAK-ve në kuadër të administrimit të detyrueshëm sepse janë jashtë objekti dhe nuk kanë lidhje me sistemin e detyrueshëm kolektiv (ekziston një kontratë distribucioni e veçantë ndërmjet QKK dhe OSHMA).
- Në lidhje me veprat audiovizuale të ritransmetuara për krijimet e vetë OSHMA-ve dhe krijimet audiovizuale jashtë Bashkimit Evropian, duhet vlerësuar se nuk janë objekt i sistemit kolektiv të detyrueshëm, dhe F.A.A.D duhet të marrë të ardhura nga sistemi i detyrueshëm kolektiv vetëm për ritransmetuesit kabllorë.
- Baza ligjore ku bazohet kërkesa e F.A.A.D (neni 97 dhe 100 (2) e LDA-së) lidhen me bashkëautorësinë dhe raportimin që producenti duhet t’u dorëzojë bashkëautorëve në lidhje me shfrytëzimin e veprës, dhe jo me shpërblimin për transmetimin e veprave nga OSHMA-të.
- Albautor bën dallimin ndërmjet muzikës së kompozuar për filmat (ku luan rol bashkëautorësia) dhe muzika e përdorur për filmat (ku hyn në lojë administrimi kolektiv i detyrueshëm). Çështja e peshës së muzikës në një vepër audiovizuale është e përcaktuar me vendim të KKDA-së (vendimi nr. 7, datë 11.10.2018) dhe qëndron në raportin 50 % me 50%, dhe ky raport shërben vetëm për ndarjen e të ardhurave që vijnë nga ritransmetuesit, huadhënia dhe kopja private.
- Në gjykimin tonë, është një numër i vogël subjektesh që kanë detyrimin të paguajnë njëkohësisht të dyja agjencitë.
- Shembulli i sallës kinematografike, e cila nuk ka detyrimin të paguajë audiovizualin për shkak se të gjithë të drejtat mbi veprën audiovizuale janë mbuluar drejtpërdrejt nëpërmjet blerjes së filmit të producenti audiovizual dhe referencat ligjore për këtë argumentim përfshijnë: nenet 99(2), 109 (6), dhe 116 (6) të LDA-së.

Kjo është arsyeja përse nuk ekziston administrimi kolektiv i detyruar për veprat audiovizuale në lidhje me shfaqjen dhe transmetimet e tyre.

Në analogji, në rastin e koncerteve live, nuk paguhet AKDIE sepse këto të drejta mbulohen drejtpërdrejt nga organizatori i koncertit nëpërmjet pagesave të bëra drejtpërdrejt tek këngëtarët dhe instrumentistët që përformojnë në koncert. Edhe rasti i transmetuesve (radiove dhe televizioneve) është i njëjtë sepse të drejtat e veprave

audiovizuale paguhen drejtpërdrejt tek mbajtësit e të drejtave nëpërmjet pagesës që këto subjekte bëjnë tek prodhuesi audiovizual.

Në lidhje me këtë, edhe vendimi nr. 7, datë 11.10.2018 i KKDA-së ka përcaktuar se për filmat artistikë/telenovelat/serialet paguhen vetëm të drejtat muzikore në territor.

- Një shembull tjetër sesi televizionet i mbulojnë drejtpërdrejt të drejtat e autorit për veprat e audiovizualit janë kontratat e transmetimit të filmave të ish-Kinostudios "Shqipëria e re", e cila është një marrëveshje që rregullon direkt interesat e palëve.
- Si përfundim, veprat audiovizuale nuk janë në administrim kolektiv për sa kohë të drejtat e autorit për produktin audiovizual, subjekti televiziv i likuajdon tek mbajtësi i të drejtave dhe nuk ka asnjë detyrim ndaj agjencisë së administrimit kolektiv të autorëve të veprave audiovizuale. Një element juridik i rëndësishëm këtu është neni 99 (1) dhe (2) i LDA-së.
- Ndryshe nga sa pretendon F.A.A.D, subjekti televiziv nuk është njëkohësisht edhe transmetues, edhe ritransmetues, sepse kuptimi ligjor për ritransmetimin është dhënë në nenin 29 të LDA-së dhe se subjektet televizive kanë marrë licensën nga AMA për ofrimin e shërbimeve të programit audioviziv dhe jo për ritransmetim.
- Ritransmetimi nuk kupton transmetimin e mëpashëm në kohë të një transmetimi, sepse ky koncept është në kundërshtim me përkufizimin e ligjit.

Po t'i referohemi shembullit shqiptar, ne i jemi drejtuar AMA për sqarim dhe nga shkresa rezulton se në Shqipëri, natyrë të dyfishtë, pra edhe transmetues, dhe ritransmetues, kanë vetëm dy subjekte që janë: "Digitalb" dhe "Tring", të cilët kanë natyrë transmetuese për ato kanale programacionin e të cilave e prodhojnë vetë si p.sh., kanalet Living, Top Neës, Big Brother Vip, etj., por edhe për kanalet tematike të filmave të drejtat e të cilave mbulohen drejtpërdrejt tek mbajtësit e të drejtave, dhe kanë natyrë ritransmetuese kur përsërisin përmbajtjen e të tretëve (dhe në këtë rast nuk kanë përgjegjësi editoriale), si p.sh. për kanalet RTSH, Klan TV, Rai Uno, CNN, MTV, etj. që ato ofrojnë në paketat e tyre.

Në konkluzionet përfundimtare, Albautor parashtron këto përfundime:

- Kërkesat e paraqitura nga F.A.A.D nuk gjejnë mbështetje as në ligj, as në praktikë, dhe qendrimi i tyre nuk bazohet në ndonjë argument të veçantë pa specifikuar se pse duhet ndjekur ndarja e propozuar e të ardhurave;
- Rastet e administrimit kolektiv të detyrueshëm parashikohen në nenin 131 të LDA-së, dhe dispozitat që lidhen me çështjen tonë janë nenet 130 (1)(a) dhe 130(1)(f).
- Neni 130 (1)(a) i LDA-së i referohet të drejtës së transmetimit, ritransmetimit dhe përcjelljes në publik të veprave joskenike, muzikore dhe letrare. Veprat muzikore përfshijnë të gjithë veprat muzikore të komunikuar në publik dhe që janë pjesë e administrimit kolektiv si e vetmja mënyrë efektive për marrjen e një autorizimi dhe pagesën për këtë përdorim në territor. Ndërkohë, qëllimi i ligjvënësit ka qenë të ketë një

trajtim të veçantë për veprat audiovizuale (të ndara nga veprat e tjera brenda vetë nenit 130 të LDA-së), për shkak të specifikës që ato kanë dhe që nxit administrimin individual dhe jo atë kolektiv. Veprat skenike nuk janë perkufizuar në ligj, por nëse i referohemi fjalorit të gjuhës shqipe, këto vepra kanë elementin skenik si element primar të identifikimit të tyre, dhe si rrjedhojë, veprat audiovizuale konsiderohen vepra skenike që nuk janë objekt i administrimit kolektiv të detyrueshëm.

- *Neni 130(1)(f) përfshin të drejtën e ritransmetimit të veprave audiovizuale në sistemin kolektiv të detyrueshëm. Mospërfshirja e veprave audiovizuale në kategoritë e dispozitës së parë tregon se qëllimi i ligjvënësit për këto vepra privilegjon administrimin individual të të drejtave, me përjashtim të rasteve të ritransmetimit të tyre. Kriteri ligjor që përcakton kuptimin e ritransmetimit krijon një tablo të qartë të të drejtave që do të administrohen në mënyrë të detyrueshme. Do të kemi administrim kolektiv për transmetimet dhe ritransmetimet e veprave muzikore, joskenike dhe letrare, dhe vetëm për ritransmetimet për veprat audiovizuale. Përfshirja e veprave audiovizuale në administrimin të detyrueshëm kolektiv vetëm për ritransmetimet është një përkthim i marrëdhënies kontraktore që një producent vendos me distributorët e filmave dhe ky i fundit më OSHMA-të në lidhje me transmetimet, ku të gjithë pagesat për krijuesit e tjerë (regji, skenar dhe kompozim) janë shlyer tashmë me pagesën që OSHMA-ja ka kryer tek subjekti që shpërndan filmin.*
- *Shpërndarja e pagesave që Sporteli Unik merr nga OSHMA-të për “filmat, serialet dhe telenovelat” duhet të kryhet në mënyrë ekskluzive vetëm tek Albautor (kuptohet për atë pjesë që i takon autorëve).*
- *Trajtimi i rasteve përjashtimore të shpërblimit për veprat filmike ose kinematografike shqiptare të krijuara përpara 1990 nuk është në kuadër të sistemit kolektiv të detyrueshëm dhe nuk duhet të llogaritet në shpërndarjen e përgjithshme ndërmjet agjencive “Albautor” dhe “F.A.A.D” në kuadër të administrimit të detyrueshëm.*
- *Referimi në mënyrë të vazhdueshme i F.A.A.D tek nenet 97 dhe 100 të LDA-së tregon se ato nuk kanë asnjë argument ligjor mbi bazat që shpërblimi i autorëve të audiovizualit duhet të kalojë nga shpërblim individual ose bazuar në kontratë në shpërblim të detyrueshëm.*
- *Të ardhurat që vijnë nga sistemi kolektiv i detyrueshëm për transmetimet duhet të kalojnë vetëm në favor të Albautor.*
- *F.A.A.D duhet të marrë të ardhurat nga sistemi kolektiv i detyrueshëm vetëm për ritransmetuesit kabllorë.*

- Të drejtat e ritransmetimit duhet të shpërndahen mes dy agjencive në një raport sa më të ekuilibruar duke pasur parasysh se jo çdo vepër audiovizuale e ritransmetuar është objekt i sistemit kolektiv të detyrueshëm (krijimet e vetë OSHMA-ve dhe krijimet audiovizuale jashtë Bashkimit Evropian).

Tabelë me propozimet e agjencisë Albautor për përqindjen e ndarjes së shpërblimeve të mbledhura mes agjencive Albautor dhe FAAD
(Pjesa e autorëve, për efekt sqarimi, 40% që u takon autorëve, sipas ligjit, do të barazohet me 100%)

Tipologjia e subjekteve të renditura sipas Relacionit për draftin e metodologjisë (Pjesa II, Tarifat)	Albautor	FAAD	Komente
Tarifa për komunikimin në publik të veprës së mbrojtur në radio	100%	0%	
Tarifa për komunikimin në publik në televizion të veprës së mbrojtur (transmetim) - televizione kombëtare publike/private - televizione lokale - televizione kabllore / IPTV / OTT / Platforma digjitale, për aq sa kryejnë transmetim	100%	0%	
Tarifa për televizione kabllore / IPTV / OTT / Platforma digjitale (ritransmetim)	50%	50%	
Tarifa për komunikimin në publik në strukturat akomoduese (hotel/motel)	100%	0%	Përqindja do të reflektojë këtu përqindjet që zbatohet për ritransmetimet sepse asnjë prej strukturave akomoduese nuk bën ritransmetim

17. Çdo argument tjetër i parashtruar nga palët që nuk lidhet me përcaktimin e përqindjes dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimit të mbledhur ndërmjet AAK-ve “F.A.A.D” dhe “Albautor”, është jashtë objekti të procedurës administrative dhe nuk mund të merret në shqyrtim nga KKDA-ja.

III. Arsyetimi i vendimit

18. KKDA-ja, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi me kujdes të gjithë pretendimet, parashtrimet dhe materialet e paraqitura nga palët, çmon se vendimmarrja nuk mund të mbështetet vetëm në interpretimin e ngushtë dhe të izoluar të disa dispozitave të veçuara të LDA-së, të cilat kanë qenë objekt diskutimi dhe interpretimi nga palët, por duhet të bazohet në tërësinë e ligjit, duke iu referuar frymës së tij, kuptimit sistematik dhe teleologjik, si dhe qëllimit të ligjvënës.

Gjithashtu, duke qenë se LDA në faqën e parë thekson se LDA është, ndër të tjera, në harmoni me Direktivën e Këshillit 93/83/KEE, datë 27 shtator 1993, “Mbi koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kabllorë”, Celex: 31993L0083, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 248, datë 6.10.1993³, KKDA-ja ka marrë parasysh gjithashtu edhe këtë Direktivë.

19. Në bazë të nenit 138 (8) dhe (9) dhe nenit 156 (4) të LDA-së, KKDA-ja ka në kompetencë dhe përcakton me vendim përqindjen e ndarjes së shpërblimeve të mbledhura për agjencitë e administrimit kolektiv (“AAK”) të licensuara nga ministria përgjegjëse, si dhe të vendosë në lidhje me çdo pretendim të palëve për përfundimin e marrëveshjes.

Në vijim, agjencia e administrimit kolektiv “F.A.A.D” legjitimohet të paraqesë kërkesën për përcaktimin e mënyrës së ndarjes dhe vlerës së përqindjes së ndarjes së shpërblimeve të mbledhura për agjencitë e administrimit kolektiv “F.A.A.D” dhe “Albautor”.

Për këtë arsye, pas marrjes së kërkesës nga F.A.A.D, KKDA-ja filloi procedurën administrative dhe zhvilloi një hetim të plotë e të gjithanshëm administrativ në përputhje me ligjin e zbatueshëm përpara se të përfundonte procedurën me vendimarrjen dhe arsyetimin e vendimit.

20. Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to”, (i ndryshuar) (“LDA”), rregullon në mënyrë të posaçme administrimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to në pjesën V të tij.

Në përputhje me nenin 128 të LDA-së, administrimi i të drejtave të autorit dhe i të drejtave të lidhura me to përfshin një ose disa nga detyrat e mëposhtme:

- a) dhënien e autorizimit për përdorim të objektit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura, objekt i mbrojtjes, kur ky autorizim është i parashikuar me ligj;
- b) mbledhjen e shpërblimeve për përdorim të objektit të mbrojtjes;
- c) shpërndarjen e shpërblimeve të mbledhura të mbajtësit të së drejtës;
- ç) kontrollin e përdorimit të objektit të mbrojtjes;
- d) nisjen dhe mbarëvajtjen e procedurave të mbrojtjes në rastet e shkeljes së të drejtave të administruara.

Në bazë të nenit 127 të LDA-së, të drejtat e autorit mund të administrohen veçmas në mënyrë individuale për çdo vepër të autorit ose, sipas parashikimit të këtij ligji, mund të administrohen

³ Direktiva e Këshillit 93/83/KEE, datë 27 shtator 1993, “Mbi koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kabllorë”, Celex: 31993L0083, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 248, datë 6.10.1993. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:31993L0083>

bashkërisht në mënyrë kolektive nëpërmjet AAK-ve të licensuara. Në disa raste të përcaktuara shprehimisht nga ligji, administrimi kolektiv i të drejtave është i detyrueshëm.

Në lidhje me sa më sipër, ligjvënësi ka parashikuar se administrimi individual i të drejtave kryhet nga vetë mbajtësi i së drejtës ose përfaqësuesi i tij përmes kontratës së lidhur midis mbajtësit së të drejtës dhe për⁴

Nga ana tjetër, në analizë të dispozitave ligjore lidhur me administrimin kolektiv, neni 130 i LDA-së përcakton kategoritë e të drejtave që mund të jenë objekt i administrimit kolektiv, duke përfshirë:

- Administrimin kolektiv së të drejtave të autorit – neni 130 (1);
- Administrimin kolektiv së të drejtave të interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve – neni 130 (2);
- Administrimin kolektiv së të drejtave të prodhuesve të fonogramit – neni 130 (3);
- Administrimin kolektiv së të drejtave të prodhuesve (producentëve) të filmave, i cili përfshin vetëm të drejtën për shpërbllim për huazim publik të videogramave dhe të drejtën për shpërbllim për riprodhimin e një videogrami për qëllime private ose përdorim personal – neni 130 (4).

Në vijim, neni 131 i të njëjtit ligj sanksionon në mënyrë detyruese kategoritë e të drejtave që duhet administrohen nëpërmjet agjencive të administrimit kolektiv të licensuara.

21. KKDA çmon se thelbi i çështjes lidhet ngushtësisht dhe ekskluzivisht vetëm me mbledhjen e të ardhurave përmes sistemit të administrimit kolektiv dho jo me administrimin individual të të drejtave.

Në këtë kuptim, rendësi për çështjen e ndarjes së të ardhurave përmes sistemit të administrimit kolektiv paraqesin në mënyrë të veçantë dispozitat ligjore vijuese:

- Neni 130 (1)(a) i LDA-së që përcakton kategoritë e të drejtave që mund të përfshijë administrimi kolektiv i të drejtave të autorit në lidhje me veprat joskenike, muzikore dhe letrare;
- Neni 130 (1)(f) i LDA-së që përcakton të drejtën e ritransmetimit të veprave audiovizuale si kategori e të drejtave që mund të përfshijë administrimi kolektiv i të drejtave të autorit;
- Neni 131, i cili specifikon rastet e administrimit kolektiv detyrues.

Në mbështetje të nenit 131 të LDA-së, i interpretuar në lidhje me nenin 130 të së njëjtit ligj, rezulton se administrimi kolektiv është i detyrueshëm për një kategori të caktuar të drejtash.

⁴ Neni 129 (1) i Ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to”, (i ndryshuar)

Këto të drejta, të cilat ushtrohen nëpërmjet administrimit kolektiv detyrues, janë:

a) **e drejta e transmetimit dhe ritransmetimit për autorët dhe interpretuesit** - të drejtën e shfaqjeve publike, të drejtën e përcjelljes në publik, të drejtën e përcjelljes në publik të një veprë të fiksuar, të drejtën e transmetimit, të drejtën e ritransmetimit, të drejtën e përcjelljes në publik të transmetimit dhe të drejtën për të vënë në dispozicion të publikut veprat joskenike, muzikore dhe letrare; dhe të drejtën e transmetimit dhe ritransmetimit të një shfaqjeje të fiksuar; [referuar përcaktimit në pikat 1, shkronja “a”, dhe 2, shkronja “c”, të nenit 130, të LDA-së];

b) **e drejta e ritransmetimit** - të drejtën e ritransmetimit të veprave audiovizuale [e përmendur në shkronjën “f”, të pikës 1, të nenit 130, të LDA-së];

c) **e drejta për shpërblim për transmetim për prodhuesit e fonogrameve** - të drejtën për shpërblim për transmetimin dhe përcjelljen në publik të fonogramit [referuar përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 130, të LDA-së];

ç) **e drejta e qiradhënies për autorët dhe për veprat/regjistrimet muzikore, për interpretuesit dhe prodhuesit e fonogrameve** - të drejtën e shpërndarjes, përfshirë të drejtën për qira dhe të drejtën e shpërblimit, sipas parashikimeve të këtij ligji; të drejtën e qirasë së shfaqjes së fiksuar dhe të drejtën për shpërblim, referuar pikës 2, të nenit 28, të këtij ligji⁵; dhe të drejtën e qirasë së fonogramit; [referuar në pikat 1, shkronja “c”, 2, shkronja “d”, dhe 3, shkronja “c”, të nenit 130, të LDA-së];

d) **e drejta e shpërblimit për huadhënien publike për autorët, interpretuesit dhe prodhuesit e fonogrameve** - të drejtën e shpërblimit për huadhënie publike; të drejtën për shpërblim për huazim publik të shfaqjes së fiksuar; dhe të drejtën për shpërblim për huazim publik të videogrameve; [referuar në pikat 1, shkronja “ç”, 2, shkronja “dh”, 3, shkronja “ç”, dhe 4, shkronja “a”, të nenit 130, të LDA-së];

dh) **e drejta për shpërblim për riprodhimin e kopjeve private dhe përdorimit tjetër personal për autorët, interpretuesit, prodhuesit e fonogrameve, prodhuesit (producentët) e filmave dhe botuesve** - të drejtën për shpërblim për riprodhimin e veprës për qëllime private ose përdorimi personal; të drejtën për shpërblim të riprodhimit të shfaqjes së fiksuar për qëllime private dhe përdorim personal; të drejtën e shpërblimit për riprodhim të fonogramit për qëllime private ose përdorim personal; të drejtën për shpërblim për riprodhimin e një videogrami për qëllime private ose përdorim personal; dhe administrimi kolektiv i të drejtave të botuesve mund të përfshijë të drejtën për shpërblim për riprodhimin e botimeve të tyre, të shkruara për qëllime

⁵ Pika 2 e Nenit 28 të LDA-së i përcakton: Autori, i cili ka hequr dorë nga e drejta e tij e dhënies me qira në favor të një prodhuesi të fonogrameve ose një producenti filmash, ruan të drejtën për të marrë një shpërblim të drejtë për qiranë e veprës së tij, për të cilën ka të drejtën e autorit. Autori nuk mund të heqë dorë nga e drejta e shpërblimit të drejtë. Shpërblimi për qiranë do të paguhet nga personi që ka marrë me qira veprën e autorit.

private ose përdorim personal; [referuar në pikat 1, shkronja “dh”, 2, shkronja “e”, 3, shkronja “d”, 4, shkronja “b”, dhe 5, të nenit 130, të LDA-së];

e) e drejta për një shpërblim - *të drejtën për shpërblim suplementar vjetor, të referuar në nenin 115 të këtij ligji*⁶ [e përmendur në shkronjën “ë”, të pikës 2, të nenit 130, të LDA-së];

ë) e drejta e rishitjes së origjinaleve të veprave të artit - *të drejtën e rishitjes, kur veprat origjinale të artit janë duke u rishitur*; [referuar në shkronjën “d”, të pikës 1, të nenit 130, të LDA-së].

22. Më konkretisht, në lidhje me objektin e çështjes në shqyrtim nga KKDA-ja, rezulton se ligjvënësi ka përcaktuar shprehimisht rastet se kur do të zbatohet administrimi kolektiv i detyrueshëm:

a) të drejtën e transmetimit dhe ritransmetimit për autorët e veprave joskenike, muzikore dhe letrare;

b) të drejtën e ritransmetimit për ritransmetimin e veprave audiovizuale;

c) të drejtën e shpërblimit për huadhënien publike për autorët në terësi, dhe të drejtën e shpërblimit për riprodhimin e kopjeve private dhe për përdorim tjetër personal për autorët dhe producentët (prodhuesit) e filmave.

23. Në rastet e administrimit kolektiv të detyrueshëm, zbatohet prezumimi ligjor i përfaqësimit, sipas të cilit agjencia përkatëse e administrimit kolektiv konsiderohet, ipso jure, si përfaqësuese e të gjithë mbajtësve së të drejtave për kategorinë përkatëse të të drejtave dhe për repertorin përkatës, pavarësisht nga fakti nëse këta mbajtës janë ose jo anëtarë të agjencisë, dhe pa dallim të shtetësisë apo vendbanimit të tyre.

Kjo dispozitë, e parashikuar në paragrafin 3 të nenit 131 të LDA-së, është thelbësore për garantimin e funksionalitetit dhe përfaqësueshmërisë universale të repertorit të administruar.

Si rrjedhojë, çdo agjenci e licencuar për administrim kolektiv të detyrueshëm konsiderohet, për qëllimet e zbatimit të ligjit, si përfaqësuese legjitime e repertorit ndërkombëtar në fushën përkatëse të veprave.

Ky mekanizëm siguron efektivitet normativ, siguri juridike dhe shmangien e fragmentarizimit në administrimin e të drejtave, duke e bërë repertorin që administrohet në mënyrë të detyrueshme të konsiderohet si i plotë dhe i padiskutueshëm.

⁶ Neni 115 i LDA-së rregullon dispozitat e veçanta mbi të drejtat e interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve e të prodhuesve të fonogramit, të cilëve u ka mbaruar afati i mbrojtjes.

24. Përpara se të shqyrtohet mënyra e ndarjes së shpërblimit për AAK-të, KKDA-ja çmon të nevojshme të nxjerrë në pah kuptimin që ligji i jep veprave audiovizuale, rregullimi i të cilave i është rezervuar një pjese të veçantë të LDA-së: Kreu VIII, Seksioni 2, nenet 95 deri në 102.

Së pari, nga analiza në terësi e ligjit, vërehet se ligjvënësi i referohet prodhuesit të veprave audiovizuale herë me termin “*prodhues*” dhe herë me termin “*producent*”, ashtu sikurse edhe veprimtarisë së tij herë me termin “*prodhim*” dhe herë me termin “*produksion*”.

Së dyti, në kuptim të nenit 95 të LDA-së, veprat audiovizuale janë filmat kinematografikë, televizivë, filmat e animuar, reklamat ose filmat e tjerë, videot e shkurtra muzikore, dokumentarët, emisione dhe grafika televizive, si dhe veprat e tjera audiovizuale, të shprehura nga sekuenca të pamjeve lëvizëse të ndërlidhura, me ose pa zë, pavarësisht nga natyra e mjetit në të cilën ato janë të fiksuar.

Neni 96 (3) i LDA-së jep edhe përkufizimin e prodhuesit (producentit) të veprës audiovizuale: *Prodhuesi i një vepre audiovizuale është personi fizik ose juridik, i cili merr përgjegjësinë për prodhimin e veprës, si dhe siguron burimet e nevojshme teknike e financiare për realizimin e saj, sipas kushteve të kontratës.*

Neni 97 i LDA-së, i cili referohet edhe si bazë ligjore për mbështetjen e pretendimeve të F.A.A.D, përcakton listën dhe kategorinë e personave që njihen si bashkëautorë të një vepre audiovizuale.

Neni 99 i LDA-së rregullon në mënyrë specifike dhe të qartë kontratën e produksionit/prodhimit audiovizual, e cila ka si objekt rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet producentit të filmit, bashkëautorëve të veprës audiovizuale dhe autorëve të kontributeve, si dhe marrëdhëniet ndërmjet autorëve të veprës.

Nga analiza dhe interpretimi i pikës 2 të nenit 99, rezulton një parim shumë i rëndësishëm i vendosur nga ligjvënësi: *Përveçse kur parashikohet ndryshe me kontratë, do të konsiderohet se bashkëautorët dhe autorët, nëpërmjet kontratës së prodhimit të filmit, i kanë kaluar prodhuesit (producentit) të filmit, ekskluzivisht dhe pa kufizime, të gjitha të drejtat e tyre ekonomike mbi veprën audiovizuale, përkthimin e saj, transformimet audiovizuale dhe fotografitë e bëra në lidhje me këtë vepër.*

Neni 100 i LDA-së përcakton të ardhurat që vijnë nga shfrytëzimi i të veprave audiovizuale, duke njohur të drejtën e shpërblimit për autorët në raport proporcional me të ardhurat e përgjithshme që rrjedhin prej veprës (përveçse kur është rënë dakord ndryshe) dhe duke sanksionuar detyrimin e producentit të filmit që, të paktën një herë në vit, të dërgojë një raport për të ardhurat tek bashkëautorët e veprës audiovizuale.

Sipas pikës 2 të kësaj dispozite, autorët e marrin shpërblimin nga prodhuesi, përdoruesi ose agjencia e administrimit kolektiv, në bazë të marrëveshjes ndërmjet tyre.

Neni 101 (1) i LDA-së përcakton rastet se kur konsiderohet e përfunduar një vepër audiovizuale: *Vepra audiovizuale konsiderohet e përfunduar kur, sipas marrëveshjes ndërmjet regjisorit kryesor dhe prodhuesit (producentit) të filmit, kopja e parë standarde e veprës, që është objekt i kontratës, është e realizuar.*

25. Procedura dhe kriteret e përcaktuara për ndarjen e të ardhurave ndërmjet AAK-ve “F.A.A.D” dhe “Albautor” janë bazuar dhe udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, transparencës, përfshirjes së palëve të interesuara në proces, drejtësisë dhe paanshmërisë, dëgjimit të palëve, objektivitetit, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi.

26. Në ushtrim të ligjshëm të diskrecionit të saj dhe në përputhje me frymën, interpretimin sistematik e teleologjik, si dhe analizën e ligjit në tërësi dhe dispozitave konkrete të lidhura me këtë procedurë në veçanti, KKDA-ja vlerëson se:

i. Në kuptim të nenit 131 (1)(a), i lidhur me nenin 130 (1)(a) të LDA-së, e drejta e shfaqjeve publike, e drejta e përcjelljes në publik, e drejta e përcjelljes në publik të një veprë të fiksuar, e drejta e transmetimit, e drejta e ritransmetimit, e drejta e përcjelljes në publik të transmetimit dhe e drejta për të vënë në dispozicion të publikut veprat joskenike, muzikore dhe letrare, ushtrohet nëpërmjet administrimit kolektiv të detyrueshëm dhe të adhurat e grumbulluara nga Sporteli Unik duhet të ndahen vetëm për Albautor (për atë pjesë që i takon autorëve të muzikës).

Së pari, sikundër rezulton nga interpretimi i dispozitës, të gjitha format e komunikimit në publik të veprës përmes transmetimit, ritransmetimit dhe përcjelljes në publik kufizohen vetëm tek veprat joskenike, muzikore dhe letrare. Ndërkohë që kuptimi i veprave muzikore dhe letrare është i qartë, nocioni i veprave joskenike nuk është i përcaktuar shprehimisht nga ligji.

Megjithatë, duke iu referuar kuptimit që fjalori i gjuhës shqipe jep për termat “skenë”⁷ dhe/ose “skenik”⁸, rrjedh se veprat joskenike janë ato që nuk e kanë elementin skenik si element primar të identifikimit të tyre. Për pasojë, veprat audiovizuale, të cilat e kanë elementin skenik si

⁷ Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe: *skënë*, -a emër i gjinisë femërore; numri shumë; -a(t)

1. pjesa e ngritur e teatrit ku luajnë aktorët e valltarët, ku këndojnë këngëtarët etj.; tërësia e dekoreve që paraqitin vendin ku zhvillohet veprimi i një pjesë teatrale: *skënë* rrotulluese; hyri (u ngjiti, doli) në *skënë*; *prapa skenës* (fig., keq.) fshehurazi, pa e marrë vesh të tjerët, *prapa krahëve*.

2. kuptim i figurshëm; veprimtaria në teatër; teatri: *mjeshtrit e skenës*; e vuri në *skënë* e përgatiti një shfaqje dhe e dha.

3. term në teatër; nëndarje e një akti gjatë së cilës luajnë të njëjtët *personazhe*; *episod* i veçantë i një drame, i një veprë tregimtare etj.; një ngjarje, një pamje nga natyra etj., që paraqitet në një vepër *arti*, në një film, në një emision etj.; në *skënë* e tretë të aktit të dytë; *skënë* masive; *skënë komike*.

4. kuptim i figurshëm; pamje: *skënë mallëngjyese* (e papëlqyer).

5. kuptim i figurshëm; tërësia e kushteve dhe e rrethanave në të cilat zhvillohen ngjarjet politike, shoqërore etj.; *arenë*; u largua nga *skena* politike.

⁸ Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe: *skenik*, -e mbiemër; term në teatër; që lidhet me *skënë*n, i *skenës*; që bëhet sipas kërkesave të *skenës*: kulturë *skenike*; lëvizjet *skenike*; të folur *skenik*.

përbërës thelbësor dhe identifikues, përjashtohen nga fushë veprimi i kësaj dispozite, pasi ligjvënësi ka bërë të qartë diferencimin ndërmjet veprave skenike dhe atyre joskenike.

Së dyti, fakti që ligjvënësi i ka trajtuar në mënyrë të veçantë veprat audiovizuale, të ndara nga veprat e tjera brenda nenit 130 të LDA-së, tregon që qëllimi i ligjvënësit është që këto vepra audiovizuale të kenë një trajtim të veçantë për shkak të specifikës që ato mbartin në funksion të nxitjes dhe privilegjimit të administrimit individual të të drejtave në vend të atij kolektiv të detyrueshëm, me përjashtim të rasteve të ritransmetimit të tyre (*shih më poshtë*).

Në kuadër të transmetimit të veprave audiovizuale, të gjitha pagesat për autorët e tjerë (përveç atyre që lidhen me muzikën ekzistuese) janë shlyer përmes pagesës së kryer ndaj subjektit që shpërndan filmin dhe që zotëron të drejtat mbi veprën. Për rrjedhojë, këta autorë nuk mund të përfitojnë pagesë të dyfishtë, si nga blerësi i të drejtave (OSHMA-të), ashtu edhe nga AAK-ja që mbulon këto të drejta. Jo pa qëllim, ligjvënësi ka parashikuar në nenin 99 të LDA-së një rregullim specifik për kontratat e prodhimit/producentit audiovizual, i cili rregullon marrëdhënien ndërmjet producentit dhe autorëve të veprës audiovizuale. Për këtë arsye, transmetimi i veprave audiovizuale i nënshtrohet regjimit të administrimit individual të të drejtave, përveç rastit të ritransmetimit të veprave audiovizuale.

Përveçse kur parashikohet ndryshe me kontratë, do të konsiderohet se bashkëautorët dhe autorët, nëpërmjet kontratës së prodhimit të filmit, i kanë kaluar prodhuesit (producentit) të filmit, ekskluzivisht dhe pa kufizime, të gjitha të drejtat e tyre ekonomike mbi veprën audiovizuale, përkthimin e saj, transformimet audiovizuale dhe fotografitë e bëra në lidhje me këtë vepër.

Më tej, referuar me analogji rastit të koncerteve live, rezulton se edhe AAK-ja përkatëse “AKDIE”⁹ nuk grumbullon të ardhurat për këngëtarët dhe instrumentistët që performojnë drejtpërdrejt, pasi pagesa e tyre bëhet nga organizatori i koncerteve. E njëjta gjë vlen edhe për transmetuesit radiofonikë ose televizivë, ku të drejtat e veprave audiovizuale paguhen drejtpërdrejt tek mbajtësit e të drejtave përmes pagesës që këto subjekte kryejnë tek prodhuesi i veprës audiovizuale.

Në lidhje me pretendimin e F.A.A.D se, për analogji, e njëjta gjë duhet të vlejë edhe për autorët e muzikës dhe se duhet të prezumohet se të drejtat e tyre i kanë kaluar publisher-it ose editor-it, KKDA-ja konstaton se ky argument nuk qëndron, për shkak se, në ndryshim nga sa përcakohet në ligj për prodhuesin/producentin e veprës audiovizuale, LDA nuk jep asnjë përkufizim të kuptimit dhe rolit të publisher/editor-it, i cili nuk rezulton të jetë objekt i rregullimit ligjor të LDA-së.

ii. Në kuptimi të nenit 131 (1)(b), i lidhur me nenin 130 (1)(f) të LDA-së, e drejta e ritransmetimit të veprave audiovizuale ushtrohet nëpërmjet administrimit kolektiv të

⁹ Agjencia e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të interpretuesve dhe ekzekutuesve, e cila ka marrë licensimin nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit pas propozimit nga DDA.

detyrueshëm dhe të ardhurat e grumbulluara nga Sporteli Unik duhet të ndahën ndërmjet F.A.A.D dhe Albautor në masën 50% me 50%.

Ligjvënësi ka përcaktuar një përjashtim të vetëm lidhur me administrimin kolektiv detyrues të veprave audiovizuale. Në kuptim të dispozitës ligjore të mësipërme, ky përjashtim vlen vetëm për rastin e ritransmetimit të këtyre veprave.

Për të zbatuar këtë përjashtim, është e domosdoshme, së pari, të përcaktohet kuptimi dhe përkufizimi ligjor i ritransmetimit sipas LDA-së dhe, së dyti, të evidentohen subjektet që janë të autorizuar për ushtrimin e ritransmetimit.

Në lidhje me evidentimin e subjekteve të autorizuar në Republikën e Shqipërisë për ushtrimin e ritransmetimit, KKDA-ja administroi, në vlerë prove, shkresën nr. 509 prot., datë 11.02.2025, të cilën AMA ia ka drejtuar Albautor në përgjigje të kërkesës dhe pyetjeve të parashtruara nga kjo e fundit.

Sipas përmbajtjes së kësaj shkrese, rezulton se AMA konfirmon shprehimisht si më poshtë vijon:

- Subjektet transmetuese janë të gjithë subjektet që janë prodhuese të kontentit televiziv, pra subjektet që ndërtojnë programin e tyre të transmetimit me shërbime të ndryshme programore.
- Subjekte ritransmetuese janë të gjithë ato subjekte që bëjnë të mundur përsëritjen e një programi audioviziv, duke e ritransmetuar atë njëkohësisht dhe të pandryshuar, përmes një sistemi kabllor, protokollit IP ose shërbimi audioviziv në satelit.
- Në raste të veçanta, ekziston mundësia që një subjekt i kryen të dyja llojet e transmetimit, dhe rasti konkret janë shoqëritë “Digitalb” sh.a. dhe “Tring” sh.a. Në këtë rast, këto kompani janë edhe prodhuese kontenti, por janë edhe të autorizuar për përsëritjen e kontetit të palëve të treta. Pra, ato kanë në përmbajtjen e tyre programore kanale të prodhuara vetë, si dhe kanale të palëve të treta të cilat bëjnë vetëm ritransmetimin e tyre.

Për sa më sipër, ndryshe nga çfarë pretendon F.A.A.D, jo çdo subjekt televiziv është njëkohësisht edhe transmetues, edhe ritransmetues. Në Republikën e Shqipërisë, vetëm dy subjekte janë konfirmuar njëkohësisht si transmetues dhe ritransmetues: “Digitalb” dhe “Tring” si transmetues për programet që ato prodhojnë vetë dhe ritransmetues për përsëritjen e përmbajtjes së të tretëve në paketat e tyre.

Në lidhje me masën e ndarjes së të ardhurave të krijuara dhe të mbledhura nga ritransmetimi i veprave audiovizuale, KKDA-ja konstaton se vetë LDA nuk vendos ndonjë kriter të caktuar për përcaktimin e ndarjes së përqindjes dhe kjo çështje mbetet në diskrecion të vetë KKDA-së.

Së pari, për sa kohë është objektivisht e pamundur të vlerësohet dhe të identifikohet në mënyrë precize dhe konkrete pesha respektive që zënë muzika dhe audiovizuali në këto vepra, KKDA-ja ka vendosur të zbatojë një raport ekuilibruar, të drejtë, objektiv dhe proporcional, duke vendosur që të ardhurat të ndahen ndërmjet AAK-ve “F.A.A.D” dhe “Albautor” në masën 50% me 50%.

Së dyti, KKDA-ja konstaton gjithashtu se vendimi i saj i mëparshëm nr. 7, datë 11.10.2018, ka trajtuar paraprakisht raportin dhe peshën që zë muzika në një vepër audiovizuale, duke përcaktuar ndarjen e përqindjeve në masën 50% me 50%. Si rrjedhojë, KKDA-ja vendos të njëjtën përqindje, ashtu siç është përcaktuar edhe më parë në vendimin nr. 7, datë 11.10.2018 të KKDA-së.

Së treti, kjo vendimmarrje është në përputhje jo vetëm me praktikën më të mirë, por edhe me standartet e harmonizuara që ndiqen në vendet e tjera të rajonit dhe në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian lidhur me ndarjen e shpërblimeve të mbledhura ndërmjet agjencive të administrimit kolektiv.

Në këtë kuadër, KKDA ka marrë në shqyrtim dhe ka analizuar mënyrën e ndarjes së të ardhurave, informacionin dhe të dhënat e vëna në dispozicion për vendet e tjera, veçanërisht ato vende të rajonit me standarte të përafërta zhvillimi ekonomik-social, me qëllim sigurimin e një vendimmarrjeje të ekuilibruar dhe të drejtë në përputhje me parimet e përmendura më sipër. Si përfundim, KKDA-ja ka arritur në konkluzionin se edhe ndarja e të ardhurave ndërmjet agjencive homologe në këto vende është e njëjtë ose shumë e ngjashme me atë të përcaktuar në këtë vendim.

27. Gjatë hetimit administrativ të gjithanshëm të zhvilluar në kuadër të kësaj procedure, KKDA-ja ka pasur në dispozicion dokumente dhe të dhëna të paraqitura nga palët, të cilat, ndonëse të publikuara në faqet zyrtare të organizatave ndërkombëtare, janë të destinuara vetëm për anëtarët e tyre dhe shpërndahen brenda mekanizmave të brendshëm të qasjes. Këto dokumente janë marrë në shqyrtim ekskluzivisht për qëllimin e analizës së praktikave krahasuese rajonale dhe janë përdorur vetëm për nevojat e këtij procesi administrativ.

Nga dokumentet dhe të dhënat e vëna në dispozicion, KKDA-ja iu referua gjithashtu të dhenave nga Konfederata Ndërkombëtare e Shoqatave të Autorëve dhe Kompozitorëve (CISAC)¹⁰ dhe dokumenteve zyrtare të organizatave homologe në rajon, si më poshtë evidentohet:

▪ **Slloveni:**

SAZAS Society k.o.¹¹ - *Shoqëria kolektive sllovene për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave muzikore të autorëve.*

¹⁰ CISAC – the International Confederation of Societies of Authors and Composers - <https://www.cisac.org/about/cisac-overview>

¹¹ SAZAS - <https://www.sazas.org/>

AIPA¹² - *Shoqata e Menaxhimit Kolektiv të Autorëve, Interpretuesve dhe Producentëve të Filmit të Veprave Audiovizuale të Sllovenisë*: Organizatë, qëllimi dhe veprimtaria parësore e së cilës është zbatimi kolektiv dhe siguri i të drejtave të autorëve, interpretuesve dhe producentëve të veprave audiovizuale.

▪ **Kroaci:**

HDS-ZAMP – *Shoqata e Kompozitorëve Kroatë – Shoqëri e Administrimit Kolektiv*¹³: Shërbim profesional për mbrojtjen e së drejtës së autorit në muzikë (ZAMP) i Shoqatës së Kompozitorëve Kroatë (HDS) – një shoqatë qytetarësh (autorë, kompozitorë, tekstshkrues) që merret me mbrojtjen dhe promovimin e repertorit muzikor kroat dhe me administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve të veprave muzikore.

DHFA – *Shoqata e Autorëve dhe Producentëve të Filmit të Kroacisë*¹⁴: Shoqatë profesionale, vullnetare dhe jofitimprurëse e regjisorëve të filmave si bashkautorët kryesorë dhe e skenaristëve, si dhe e bashkëautorëve të tjerë audiovizualë (drejtorë fotografie, montazhierë, animatorë dhe karikaturistë), si dhe e mbajtësve të tjerë të të drejtave në fushën audiovizuale.

▪ **Serbi:**

SOKOJ - *Organizata e Autorëve të Muzikës Serbe*¹⁵: Organizatë jofitimprurëse për menaxhim kolektiv, që administron të drejtat e kompozitorëve, autorëve të teksteve, aranzhuesve dhe mbajtësve të tjerë të të drejtave mbi veprat muzikore të të gjitha zhanreve.

Nga analiza e këtyre të dhënave, u konstatua se ekziston një ndarje e qartë kompetencash ndërmjet organizatave të administrimit kolektiv. Në të gjitha rastet e shqyrtuara, organizatat që administrojnë të drejtat audiovizuale fokusohen kryesisht tek të ardhurat nga ritransmetimi dhe kompensimet për kopje private, ndërsa organizatat për të drejtat muzikore mbulojnë transmetimet, ritransmetimet, shfaqjet publike dhe përdorimet e tjera kolektive.

Në përputhje me këto të dhëna dhe me praktikën e konsoliduar në rajon, KKDA-ja konstaton se ndarja e tarifave të propozuara është në harmoni me modelet e aplikuar në vendet fqinje dhe pasqyron një praktikë të drejtë dhe të balancuar të administrimit kolektiv të të drejtave ndërmjet muzikës dhe audiovizualit.

iii. Rasti përjashtimor: Veprat filmike dhe/ose kinematografike shqiptare të krijuara përpara vitit 1990

Për sa i përket veprave filmike dhe/ose kinematografike të krijuara përpara vitit 1990, KKDA-ja konstaton se ekziston një kontratë distribucioni e veçantë, e lidhur ndërmjet QKK-së dhe

¹² Collecting Society of Authors, Performers and Film Producers of Audiovisual Works of Slovenia, k.o. - <https://www.aipa.si/>

¹³ ZAMP - <https://www.zamp.hr/o-nama/ovo-je-hds-zamp/pregled/439/tko-smo-mi>

¹⁴ Croatian Film Authors' and Producers' Association - <https://dhfr.hr/>

¹⁵ Serbian Music Authors' Organization - <https://www.sokoj.rs/>

OSHMA-ve. Pavarësisht se si është vepruar më parë nga SUADA, KKDA-ja konsideron se kjo çështje është jashtë objektit të procedurës administrative.

28. Si përfundim, KKDA-ja vlerëson dhe vendos siç vijon:

- Do të kemi administrim kolektiv detyrues për transmetimin dhe ritransmetimin e veprave joskenike, muzikore dhe letrare, në bazë të nenit 130 (1)(a) të LDA-së, dhe në kuptim të fjalorit të gjuhës shqipe (për sa kohë mungon përkufizimi në ligj), veprat audiovizuale nuk janë vepra joskenike sepse elementi skenë është element i identifikimit primar të tyre;
- Do të kemi administrim kolektiv detyrues për ritransmetimin e veprave audiovizuale, në bazë të nenit 130(1)(f) të LDA-së;
- Do të kemi administrimin kolektiv detyrues për huadhënien publike dhe riprodhimin e kopjeve private për autorët dhe producentët (prodhuesit) e filmave.
- Ndarja e shpërblimit të mbledhur nga SUADA për AAK-të “F.A.A.D” dhe “Albautor”, sipas objektit të këtij vendimi, do të bëhet në mënyrën e përcaktuar në Aneksin 1 bashkëlidhur.

29. Në lidhje me kërkesat dhe argumentet e parashtruara nga F.A.A.D, KKDA-ja vlerëson se ato nuk janë të bazuara në ligj. F.A.A.D nuk evidenton asnjë arsyetim ligjor për të justifikuar ndarjen e propozuar dhe nuk referon ndonjë dispozitë konkrete ligjore që të mbështesë kërkesën e saj.

- F.A.A.D referon tek nenet 97 dhe 100 (2) të LDA-së për të bazuar pretendimet e saj për ndarjen e shpërblimit të autorëve të veprave audiovizuale, por asnjëri prej këtyre neneve nuk tregon ndonjë të drejtë ligjore dhe as nuk evidenton ndonjë detyrim të caktuar për të shpërndarë të ardhurat përmes sistemit të administrimit kolektiv detyrues.
- Neni 97 i LDA-së thjesht përcakton se cilët janë personat bashkëautorë në një vepër audiovizuale;
- Neni 100 i LDA-së evidenton vetëm të drejtën e këtyre autorëve për të përfituar nga shfrytëzimi i veprave të tyre dhe raportin që producenti duhet t’u dorëzojë bashkëautorëve në lidhje me shfrytëzimin e veprës.

IV. Dispozitivi i vendimit

Në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, si dhe pasi shqyrtoi të gjithë materialet dhe dokumentacionin e paraqitur nga palët pjesëmarrëse në këtë procedurë administrative, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e mënyrës së ndarjes dhe vlerës së përqindjes së ndarjes së shpërblimeve të mbledhura për agjencitë e administrimit kolektiv "F.A.A.D" dhe "Albautor", sipas Aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, i cili është pjesë përbërëse e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
3. Kundër vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Autorit, palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankim në Gjykatën Administrative kompetente në përputhje me afatet dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi. Afati i ankimit llogaritet nga data e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
4. Ngarkohet sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Autorit për njoftimin e këtij vendimi.

Kryetari i KKDA-së

Znj. Erjola Aliaj



Sekretariati Teknik

Znj. Borana Ajazi

ANEKSI 1

**Tabela e përcaktimit të përqindjes së ndarjes së shpërblimeve të mbledhura
ndërmjet agjencive të administrimit kolektiv
“F.A.A.D” dhe “Albautor”**

Nr.	Tipologjia e subjekteve	Albautor	F.A.A.D
1.	TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK TË VEPRËS SË MBROJTUR NË RADIO	100%	0
2.	TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK TË VEPRËS SË MBROJTUR NË TELEVISION	100%	0
3.	TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK NË STRUKTURAT AKOMODUESE (HOTEL/ MOTEL)	100%	0
4.	TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK TË VEPRËS SË MBROJTUR NË VENDE KU KONSUMOHEN USHQIME DHE/OSE PIJE	100%	0
5.	TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK TË VEPRËS SË MBROJTUR NË NJËSI TREGTARE DHE MJEDISE TË TJERA BIZNESI	100%	0
6.	AKTIVITETE BIZNESI TË TJERA KU KOMUNIKOHEN NË PUBLIK VEPRAT E MBROJTURA	100%	0
7.	TARIFA PËR RITRANSMETIMET NË TELEVISIONE KABLLORE / IPTV / OTT / PLATFORMA DIGJITALE	50%	50%
8.	TË ARDHURA NGA KOPJA PRIVATE	50%	50%